




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18, dt. 08.08.2018, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për subvencione në fushën e Kulturës.
- II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Visar Krusha, kryesues,
 2. Munish Hyseni, anëtar,
 3. Selvete Shala, anëtare,
 4. Valdet Rama, (anëtar rezervë).
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që të mblidhet sa herë që paraqitet nevoja dhe të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për mos kualifikim, si pasojë e mos përmbushjes së kritereve procedurale të parapara në thirrjen për subvencion dhe në nenet 10 dhe 11 të Rregullores MF – nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve dhe ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare. Komisioni për të gjitha takimet duhet të mbajë procesverbal, i cili duhet nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.
- IV. Mandati i komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është 3-vjeçar.
- V. Për kryerjen e këtyre detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi 14–020/04 0130553/18, dt. 31.05.2018.
- VII. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Drejtorisë së Kulturës,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti